VENDIM
Nr. 787, datë 9.11.2016

PËR NJË SHTESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2016, MIRATUAR PËR KOMISIONIN QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 dhe 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 13, të ligjit nr. 147/2015, "Për buxhetin e vitit 2016", të ndryshuar, me propozim të ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në buxhetin e vitit 2016, miratuar për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, në zërin "Shpenzime korrente", të shtohet fondi prej 4 907 000 (katër milionë e nëntëqind e shtatë mijë) lekësh, me qëllim organizmin e zgjedhjeve të pjesshme për kryetar të Bashkisë Kolonjë.

2. Efekti financiar i parashikuar në pikën 1, të këtij vendimi, të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, miratuar për vitin 2016.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi